



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 716 prot.

Tiranë, më 18.06. 2019

V E N D I M

Nr. 3 , datë 12.06. 2019

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”, ME
OBJEKT “NDËRTIMI ARGJINATURËS SË LINJËS SË TUBACIONIT
DHE DALLGËTHYESIT TË PORTIT MBM”, NË PORTO ROMANO,
BASHKIA DURRËS.**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor”, subjektit “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” sh.p.k, me objekt “Ndërtimi argjinaturës së linjës së tubacionit dhe dallgëthyesit të portit MBM”, në Porto Romano, Bashkia Durrës.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

